



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24.4.2023

Nr: 403

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

**EMËRIMIN E SEKRETARIT TË KZAZ NR. 26, ANËTARIT TË KZAZ NR. 26, BASHKIA VORË, DHE  
SEKRETARIT TË KZAZ NR. 92, BASHKIA KONISPOL, TË PROPOZUAR NGA PARTIA E LIRISË, PËR  
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 10 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Me vendimin nr. 393 datë 20.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është vendosur shkarkimi nga detyra i anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 26, Bashkia Vorë dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 92, Bashkia Konispol. Bazuar në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia e Lirisë brenda 3 (tre) ditëve duhet të depozitonte propozimin për plotësimin e vakancave të krijuara së bashku me dokumentacionin përkatës.

Partia e Lirisë me shkresën nr. 4120 prot., datë 24.4.2023, ka depozituar dokumentacionin për sekretarin e KZAZ-së nr. 26, anëtarin e KZAZ-së nr. 26, Bashkia Vorë, dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 92, Bashkia Konispol.

Pas kryerjes së verifikimit të dokumentacionit, dhe verifikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultojnë që propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

Data: 24.4.2023 Nr: 403  
Ora: 15:00



“Për emërimin e sekretarit të KZAZ nr.26, anëtarit të KZAZ nr.26, Bashkia Vorë, të sekretarit të KZAZ nr.92, Bashkia Konispol, të propozuar nga Partia e Lirisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## V E N D O S:

1. Emërimin e sekretarit të KZAZ-së nr. 26, z. Atmir Demir Mani, anëtarit të KZAZ-së nr.26, z. Sokol Baftiar Kuçi, Bashkia Vorë, dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 92, z. Klodian Naim Lame, Bashkia Konispol, të propozuar nga Partia e Lirisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**